



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 11662 prot.

Shkodër, më 19.05. 2026

VENDIM

Nr. 42, datë 18.05.2026

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR. 35, DATË 30.04.2026, "PËR MIRATIMIN E KËRKESËS SË BASHKISË SHKODËR, SË BASHKU ME DOKUMENTACIONIN TEKNIKO-LIGJOR, PËR AKORDIMIN E NDIHMËS FINANCIARE PËR FAMILJEN E ZNJ. SHPRESA DHAMCA, BANESA E SË CILËS ËSHTË DËMTUAR NGA ZJARRI"

Këshilli Bashkiak i Bashkisë Shkodër, në mbledhjen e tij të datës 18.05.2026, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, mbështetur në Ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar; Ligjin nr. 45/2019 "Për mbrojtjen civile"; Ligjin nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", i ndryshuar; Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 329, datë 16.05.2012 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore"; Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 414, datë 08.07.2021 "Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile", i ndryshuar; Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 84, datë 18.12.2025 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2026 dhe të programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2026–2028 të Bashkisë Shkodër", i ndryshuar; Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 40, datë 30.04.2026 "Për shtesë në buxhetin e vitit 2026"; Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 35, datë 30.04.2026 "Për miratimin e kërkesës së Bashkisë Shkodër, së bashku me dokumentacionin tekniko-ligjor, për akordimin e ndihmës financiare për familjen e znj. Shpresa Dhamca, banesa e së cilës është dëmtuar nga zjarri", si dhe në dokumentacionin e përgatitur nga administrata e bashkisë,

VENDOSI:

Adresa: Rr. "13 Dhjetori", Nr.1, Shkodër, web: www.bashkiashkoder.gov.al. e-mail: info@bashkiashkoder.gov.al

1. **Miratimin e ndryshimeve në pikat 2 dhe 4 të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 35, datë 30.04.2026,** “Për miratimin e kërkesës së Bashkisë Shkodër, së bashku me dokumentacionin tekniko-ligjor, për akordimin e ndihmës financiare për familjen e znj. Shpresa Dhamca, banesa e së cilës është dëmtuar nga zjarri”.

2. **Pika 2 e Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 35, datë 30.04.2026, ishte:**

“Të miratojë dokumentacionin tekniko-ligjor të hartuar nga Bashkia Shkodër, për familjen e znj. Shpresa Dhamca, në vlerën e dëmit nga ana ndërtimore prej 484 695 (katërqind e tetëdhjetë e katër mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e pesë) lekë dhe për dëmet në orendi prej 218 000 (dyqind e tetëmbëdhjetë mijë) lekë, sipas preventivave të Komisionit të Vlerësimit të Dëmeve pranë Bashkisë Shkodër.”

Bëhet:

“Të miratojë dokumentacionin tekniko-ligjor të hartuar nga Bashkia Shkodër, për familjen e znj. Shpresa Dhamca, në vlerën e dëmit nga ana ndërtimore prej 245 998 (dyqind e dyzet e pesë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e tetë) lekë dhe për dëmet në orendi prej 218 000 (dyqind e tetëmbëdhjetë mijë) lekë, sipas preventivave të Komisionit të Vlerësimit të Dëmeve pranë Bashkisë Shkodër.”

3. **Pika 4 e Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 35, datë 30.04.2026, ishte:**

“Për familjen e znj. Shpresa Dhamca, kompensimi i dëmeve materiale ndërtimore dhe i dëmeve në orendi e pajisje do të bëhet sipas preventivave të vlerësimit, të hartuara nga grupi i verifikimit dhe vlerësimit, në zbatim të Ligjit nr. 45/2019 ‘Për mbrojtjen civile’, neni 41; të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 329, datë 16.05.2012, pika 3; si dhe të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 414, datë 08.07.2021, pika 3.1/a, ‘Për miratimin e procedurave dhe kritereve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile’, sipas relacionit bashkëlidhur, në masën 50% të vlerës ndërtimore, në shumën 242 348 (dyqind e dyzet e dy mijë e treqind e dyzet e tetë) lekë, dhe në masën 50% të vlerës së orendive, në shumën 109 000 (njëqind e nëntë mijë) lekë, pas akordimit të fondeve nga Ministria e Mbrojtjes/Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile.”

Bëhet:

“Për familjen e znj. Shpresa Dhamca, kompensimi i dëmeve materiale ndërtimore dhe i dëmeve në orendi e pajisje do të bëhet sipas preventivave të vlerësimit, të hartuara nga grupi i verifikimit dhe vlerësimit, në zbatim të Ligjit nr. 45/2019 ‘Për mbrojtjen civile’,

neni 41; të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 329, datë 16.05.2012, pika 3; si dhe të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 414, datë 08.07.2021, pika 3.1/a, 'Për miratimin e procedurave dhe kritereve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile', sipas relacionit bashkëlidhur, në masën 50% të vlerës ndërtimore, në shumën 122 999 (njëqind e njëzet e dy mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë) lekë, dhe në masën 50% të vlerës së orendive, në shumën 109 000 (njëqind e nëntë mijë) lekë, pas akordimit të fondeve nga Ministria e Mbrojtjes/Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile.”

4. Pikat e tjera të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 35, datë 30.04.2026, mbeten të pandryshuara.
5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë Shkodër.
6. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

Miratuar me 34 vota

Vota Pro	34
Vota Kundër	0
Vota Abstenim	0
Zbardhur me datë	18.05.2026

SEKRETARE

Sabina Dana

KRYETAR

Oltion Luli

